



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria e Arsimit
Nr.07-Zyrtarisht
28.05.2021

Në bazë të nenit 64, paragrafi 1 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 06/L-114, nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik, Udhëzimi Administrativ MASHT Nr. 05/2015 Normativi Për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional, Drejtoria Komunale e Arsimit në Deçan, shpallë këtë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës


Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vend i Lirë /Me kohë të caktuar / Zëvendësim	Numri i pozitave
1	Shkolla Mesme Teknike "Tafil Kasumaj" në Deçan	Mësimdhënësi i/e Ekonomisë (Kontabilitet dhe Financa 10 orë)	Kohë të Caktuar (mandati i drejtorit të shkollës)	1
2	Shkolla Mesme Teknike "Tafil Kasumaj" në Deçan	Mësimdhënësi i/e Ekonomisë (Menaxhimi i Turizmit dhe Hotelerisë 20 orë)	Zëvendësim Lehonie	1

I. Kriteret e kualifikimit për pozitën:

1. Mësimdhënësi i/e Ekonomisë (Kontabilitet dhe Financa) kërkohet: 1.MSc. i ekonomisë- profilin përkatës; 2.Ekonomist i diplomuar banka, financa, kontabilitet; 3.Ekonomist i diplomuar - përgjithshëm.
2. Mësimdhënësi i/e Ekonomisë (Menaxhimi i Turizmit dhe Hotelerisë) kërkohet: 1. MSc. i turizmit dhe hotelerisë; 2. Ekonomist i diplomuar i turizmit dhe hotelerisë.

II. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit;
- Rezumeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta - kopje);
- Diploma e kualifikimit e noterizuar;
- Trajnime (nëse ka);
- Vërtetimin për përvojën e punës (nëse ka);
- Certifikata që nuk jeni nën hetim;
- Certifikata e lindjes;
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHT.



III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Për listë të ngushtë do të ftohën vetëm kandidatët, të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura, në mungesë kualifikimi i përafërt.

Sqarim: Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje, (kualifikimet universitare duhet të jenë të noterizuara), dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistës.

Formularin i Aplikimit për Punësim shkarko këtu:

<https://kk.rks-gov.net/decan/wp-content/uploads/sites/9/2021/01/Formulari-Aplikimi-Per-Punesim-07AR.pdf>

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes së konkursit në faqen zyrtare të komunës, duke filluar nga data e publikimit më: 28.05.2021 më datën: 12.06.2021.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes zyrës së DKA-së Nr. 52, në objektin e Komunës së Deçanit.

Drejtori
Ma. sc. Bekim Vishaj